



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prinjenje/Prudato Received/Delivered	18.12.2020	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot In Prot Prot No	Shtepja Puleg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/HCU	3196/2020		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A Nr. 389/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Arben Mehmeti, Malsore Gashi- Bajraktari - anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.389/2020, të datës 04.12.2020, së ankuesit [REDACTED] me adresë banimi rruga e Mërgimtarëve pa numër Zselle , nga Komuna e Mitrovicës, sipas aktgjykimit A.nr 1989/2018, të datës 27.11.2020, të Gjykatës Themelore ne Prishtine Departamenti për Çështje Administrative, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike “ kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën Nr. 389/2020, e datës 04.12.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.07.2018, me numër A. Nr. 339/2018, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi [REDACTED] i pakënaqur me vendimin e datës 11.07.2018, me numër A. Nr. 339/2018, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.08.2018, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore Themelore/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 27.11.2020, me numër A. Nr. 1989/2018, ka nxjerr aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar vendimin e datës me datë 11.07.2018, me numër A. Nr. 339/2018, duke e kthyer çështjen në rivendosje dhe rishqyrtim.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 389/2020, e datës 04.12.2020, me numër protokoll 2939/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Padia e datës 13.08.2018, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë;

Vendimi i datës 07.05.2018, me numër protokoll 01-11/01-0031605-4/18, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesë e datës 24.04.2018, me numër protokoll 01-111/01-0031605/18, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve të Ankesave; Vendimi i datës 04.04.2018, i Këshillit të



drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve të Ankesave; Vendimi i datës 04.04.2018, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raporti i datës 11.04.2018; Autorizimi i datës 20.2.2018, i Ministrisë së Administratës Publike/ Departamenti për Çështje Administrative; Raporti final nga Komisioni rekrutues; konkursi i datës 22.02.2018; Regjistrimi i Aplikacioneve të Pranuara; vlerësimi i kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë; deklaratë e datës 02.03.2018; Vendimi i datës 06.03.2018, për Themelimin e Komisionit përzgjedhës; Akt emërimi i datës 20.08.2012; vendimi i datës 09.01.2017; për emërimin e përkohshëm; Kontrata e punës e datës 19.02.2014; Akt emërimi i datës 15.04.2016; njoftimi i datës 26.03.2018, për përzgjedhjen e kandidatit; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidateve; Vendimi i datës 23.03.2018; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen e listën e ngushtë; Lista e pjesëmarrjes; Vlerësimi individual i kandidateve për testim me shkrim; testim me shkrim për pozitën „Menaxher i Personelit”, Kërkesa për punësim e z. [REDAKTUAR], me shkresat e bashkangjitura; Vërtetimi i datës 27.02.2018; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë; Certifikatë e datës 14-15, e muajit prill e vitit 2014; Certifikatë e datës 09-10, e muajit tetor të viti 2017; Diplomë e datës 23.12.2013; Vlerësimi individual i kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Diplomë e datës 04.03.2009; vërtetim i datës 20.02.2018; Vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 01.03.2018; Kërkesa për punësim e z. [REDAKTUAR], me shkresat e bashkangjitura; kontrata për shërbime të veçanta e datës 09.09.2013; vërtetim i datës 01.06.2010; diplomë; vendimi i datës 08.09.2017; kërkesë për lirim nga detyra e datës 01.03.2018; kërkesë e datës 15.08.2014; vërtetim i datës 25.08.2014; Akt emërimi i datës 20.04.2014; vendimi i datës 12.06.2013; Përgjigja në ankesë e datës 25.06.2018, me numër protokoll 3531/2018, me shkresat e bashkangjitura, Akt Gjykimi i datës 27.11.2020, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit [REDAKTUAR], është bërë i pamundur *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar me datë 27.11.2020, me numër A. Nr. 1989/2018, të Gjykatës Themelore Themelore/Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke anuluar vendimin e datës me datë 11.07.2018, me numër A. Nr. 339/20108, duke e kthyer çështjen në rivendosje dhe rishqyrtim, mirëpo kërkesën për tërheqje të ankesës ankuesi Gani Mustafa e ka parashtruar me datë 07.12.2020 me numër protokoll 2982/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Prandaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se procedimi administrativ i iniciuar me ankesë është bërë i pamundur.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas tërheqjes së ankesës nga ana e ankuesit konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e ankuesit e përcaktuar me dispozitat nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/1.-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *”Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, andaj bazuar në këtë veprim administrativ të ankuesit, konstatohet se është përmbushur kushti ligjor për të vendosur për përfundim të procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës me numër protokoll 2982/2020, e parashtruar nga ankuesi [REDAKTUAR].

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

[REDAKTUAR]

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 389/2020



Rushit KAJTAZI
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Gjyqtarit Hajriz Hoti
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamentit për Çështje Administrative
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

